



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 30 shtator 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: gusht, 2024

- Në gusht të vitit 2024, norma mesatare e interesit të kredive të reja shënon 5,44% dhe shënon rënie mujore dhe vjetore prej 0,02 p.p. dhe 0,05 p.p., respektivisht. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave shënoi rritje mujore dhe vjetore prej 0,03 p.p. dhe 0,41 p.p., respektivisht dhe arrin 1,96%.
- Te norma mesatare e interesit të kredive të reja², në gusht është arritur rënie mujore dhe vjetore prej 0,08 p.p. dhe 0,49 p.p., respektivisht dhe arrin 5,04%. Norma mesatare e interesit për depozitat e reja, në gusht, është ulur për 0,33 p.p. në bazë mujore dhe është 2,43%, me rritje vjetore prej 0,26 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja në total

	8.2023	9.2023	10.2023	11.2023	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.49	5.49	5.49	5.48	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44
Korporatat	5.36	5.37	5.37	5.36	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20
Amviseritë	5.61	5.61	5.60	5.59	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66
Kreditë e reja	5.53	5.49	5.55	5.38	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04
Korporatat	5.73	5.50	5.71	5.39	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90
Amviseritë	5.24	5.47	5.28	5.35	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28
Depozitat	1.55	1.59	1.67	1.74	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96
Korporatat	2.08	1.94	1.96	2.23	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20
Amviseritë	1.50	1.55	1.64	1.69	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93
Depozitat e reja	2.17	2.15	2.32	2.28	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43
Korporatat	1.81	1.65	1.51	1.71	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99
Amviseritë	2.32	2.40	2.57	2.46	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76

Burimi: BPRMV-ja.

¹Me termin "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf


²Lidhur me normata e interesit të kredive të reja / depozitat e reja janë karakteristike zhvillime të ndryshueshme. Lëvizjet e tilla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord rishtazi e interesit.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

1. Norma të interesit në sektorin korporativ³


- Në gusht, norma e interesit e totalit të kredive të sektorit korporativ është ulur për 0,03 p.p. në bazë mujore dhe është 5,20%. Ndryshimi në rënie vjen si pasojë e rënies së normave të interesit për të gjithë komponentët dhe atë: norma e interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,04 p.p. dhe 0,03 p.p., përkatësisht) dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaja (për 0,02 p.p.). Në bazë vjetore, norma e interesit të totalit të kredive të sektorit korporativ shënon rënie prej 0,16 p.p.




Burimi: BPRMV-ja.



- Norma e interesit e kredive të reja të sektorit korporativ, këtë muaj, arrin 4,90% dhe shënoi rënie mujore prej 0,06 p.p. Analizuar sipas valutës, rënia rezulton nga ulja e normave të interesit për kreditë valutore dhe kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,23 p.p. dhe 0,12 p.p., përkatësisht), me rritje të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,79 p.p.). Krahasuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit është më e ulët për 0,83 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.





³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në gusht, norma mesatare e interesit për depozitat totale të sektorit korporativ, shënoi rënie mujore prej 0,08 p.p. dhe shënon 2,20%. Rritja rezulton nga normat e reduktuara të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe të normave të interesit të depozitave valutore (për 0,10 p.p. dhe 0,09 p.p., respektivisht), me norma të pandryshuara të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore. Krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është rritur për 0,12 p.p.
- Norma e interesit të depozitave të reja⁴ të sektorit korporativ, këtë muaj, është ulur për 1,04 p.p. në bazë mujore dhe shënon 1,99%. Ndryshimi në rënie është rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe normave të interesit të depozitave valutore (për 1,13 p.p., përkatësisht 0,44 p.p.). Këtë muaj, bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Norma e interesit të depozitave të reja të sektorit korporativ është rritur për 0,18 p.p. në bazë vjetore.

2. Norma të interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV-ja.



- Në gusht, norma e interesit e totalit të kredive të amvisërive, arrin 5,66% dhe shënon rënie mujore prej 0,01 p.p. Njëkohësisht, rënia tërësisht vjen si rezultat i uljes së normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,02 p.p.), në kushte të normave të pandryshuara të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore dhe kredive valutore. Kjo normë e interesit është rritur për 0,05 p.p. në bazë vjetore.
- Te norma mesatare e interesit të kredive të reja të amvisërive, në gusht, shënoi rënie mujore prej 0,06 p.p. dhe arrin 5,28%. Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit për kreditë e reja të sektorit amvisërive është rritur për 0,04 p.p.

⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV-ja.

- Në gusht, norma e interesit e depozitave totale të amvisërive është 1,93% dhe në nivel mujor është rritur për 0,04 p.p. Ndryshimi në rritje vjen si pasojë e rritjes së normave të interesit për të gjithë komponentët: normat e interesit të depozitave në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,12 p.p. dhe 0,05 p.p., përkatësisht) dhe normat e interesit të depozitave valutore (për 0,03 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënoi rritje prej 0,43 p.p.
- Norma e interesit e depozitave të reja të amvisërive⁶, këtë muaj, është më e lartë për 0,08 p.p. dhe arrin 2,76%. Rritja mujore vjen si rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe të normave të interesit të depozitave valutore (për 0,08 p.p. dhe 0,07 p.p., respektivisht), në kushte kur te bankat dhe kursimoret nuk janë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Krahësuar në bazë vjetore, norma e interesit e depozitave të reja të amvisërive është rritur për 0,44 p.p.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione mbështetëse

Seri kohore të të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publikimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 31 tetor 2024 (mesatare referuese, përfshirë shtatorin e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235, lok. 108/110.